

NDËRKOMBËTARIZIMI I NMVM SHQIPTARE CERTIFIKIMET




invest in Albania


2023



Përmbajtja

Hyrje	4
Rëndësia e Certifikimeve	4
Pse duhet të certifikohen sipërmarrjet	5
Përfitimet e certifikimeve	6
Llojet e certifikimeve	7
Trupat certifikuese	13





Hyrje

Certifikimi është një ndër proceset më të rëndësishme që lidhet me cilësinë, sigurinë, aksesin në tregje, besueshmërinë dhe garancinë për konsumatorin. Bizneset shqiptare ende vazhdojnë të hasin barriera për tregtimin e produkteve të tyre dhe në shumicën e rasteve, shkak është moszotërimi i certifikatave të nevojshme që garantojnë standarde.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), bazuar në objektivat e saj për të ofruar shërbime për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro të vogla dhe të mesme me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë dhe nxitjen e eksporteve, harton këtë botim mbi rëndësinë e certifikimeve dhe llojeve të tyre.

Ky botim do t'ju shërbejë NMVM-ve shqiptare për orientim dhe informim mbi standardet e kërkuara dhe të pranura nga Bashkimi Evropian, me qëllim aksesin e tyre në tregjet evropiane me produktet "Made in Albania".

Rëndësia e Certifikimeve

Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), në Ballkanin Perëndimor ballafaqohen me vështirësi sa i përket qasjes në tregje të reja për eksport. Një parakusht është përshtatja e produktit dhe e standardit të cilësisë për ato tregje të synuara. Përveç kësaj, për eksport të suksesshëm nevojiten edhe informata për tregun dhe kanalet e shpërndarjes.

Rregullat e tregtisë ndërkombëtare, rregulloret e BE-së dhe procedurat e importit, standardet private të cilësisë së industrisë, si dhe performanca shtesë ose shenjat e cilësisë (që nuk janë domosdoshmërisht të kërkuara ligjërisht, por që bëhen kusht i qasjes në treg), mund të jenë një pengesë e vështirë për kompanitë që dëshirojnë të hyjnë në tregjet e BE-së dhe tregjet e tjera ndërkombëtare. Në shumë raste, produktet duhet të testohen dhe të certifikohen për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e importuesve për të dëshmuar se kërkesat e BE-së dhe standardet private të cilësisë së industrisë janë duke u përmbushur.

Qasja në tregje përmes certifikimit është vetëm fillimi. Certifikimi ofron një pasaportë vendimtare që mundëson hyrjen në tregjet me vlerë më të lartë. Për të maksimizuar shitjet, rritjen dhe krijimin e vendeve të punës, eksportuesit duhet të (ri)investojnë vazhdimisht për menaxhimin e eksportit, zhvillimin e biznesit, brandimin, marketimin dhe inovacionin.

Bizneset shqiptare ende vazhdojnë të hasin barriera për tregtimin e produkteve të tyre dhe në shumicën e rasteve, shkak është moszotërimi i certifikatave të nevojshme që garantojnë standarde. Kjo është e vështirë, sidomos për ata që duan të eksportojnë dhe ku konkurrenca bëhet edhe më agresive.



Pse duhet të certifikohen sipërmarrjet

Shumica e eksporteve shqiptare janë të orientuara kryesisht drejt tregjeve të hapura në vendet e Ballkanit si: Serbi, Kosovë, Mali i Zi, Bosnje Herzegovinë dhe Maqedoni, por këto vende janë lehtësisht të arritshme nga eksportuesit shqiptarë, pasi kërkesat mbi cilësinë dhe sigurinë ushqimore janë më të ulta krahasuar me tregjet e zhvilluara Evropiane dhe në pjesën më të madhe të rasteve nuk kanë kërkesa specifike që lidhen me standardet e marketingut (paketim, brandim, etiketim, kalibrim, etj.), por nga ana tjetër, çmimet që arrihen në këto tregje janë mjaft të ulta krahasuar me tregjet e zhvilluara perëndimore. Gjithnjë e më shumë, tregjet kërkojnë standarde dhe certifikim të produktit nga prodhuesit.

Megjithatë, certifikimi është një sfidë jo e lehtë për prodhuesit, vështirësia lidhet me mungesën e burimeve të mjaftueshme, njohurive teknike dhe fondeve të nevojshme. Gjithashtu, ata konkurojnë me prodhuesit e mëdhenj tregtar përsa i përket volumeve të prodhimit dhe aksesit në tregje. Por, edhe prodhuesit e mëdhenj hasin vështirësi në zhvillimin e një strategjie të mirëfilltë marketingu dhe kostot e inputeve dhe lëndëve të para janë një shqetësim real për ta.

Më poshtë disa nga arsyet pse duhet të certifikohen sipërmarrjet:

Standardizimi

- 1 Thjeshton prodhimin.
Garanton qëndrueshmërinë dhe sigurinë e produktit.
Promovon bashkëpunimin dhe pajtueshmërinë ndërkombëtare.

Kënaqësia e kërkesave të klientit

- 2 Kjo është një arsye për të cilën shumë kompani duan të certifikohen vetëm për të përmbushur një kërkesë të klientit. Në raste të tjera, klienti deklaron se do të bëjë biznes vetëm me furnitorë të certifikuar. Certifikimi duhet të jetë i vazhdueshëm dhe progresiv duke e bërë pjesë kompaninë në disa dhe jo vetëm një certifikatë.

Përmirëson cilësinë e proceseve dhe produkteve

- 3 Miratimi i një metode të standardizuar, në përputhje me certifikimin, ka të bëjë me cilësinë. Rezultati përfundimtar i një certifikimi është një nivel më i lartë i cilësisë për të gjithë organizatën dhe për çdo proces dhe produkt.

Përmirëson qëndrueshmërinë e operacioneve

- 4 Reduktimi i variacionit në procese është përcaktimi më i mirë i qëndrueshmërisë. Klientit i shërbehet më së miri kur ofron një produkt të qëndrueshëm, me të njëjtat dimensione, të njëjtën peshë, të njëjtat toleranca dhe të njëjtin prodhim.

5

Përmirëson efikasitetin, zvogëlon mbeturinat dhe kursen para

Një sistem i menaxhimit nuk është i përsosur, por një sistem i implementuar mirë lejon që kompania t'i afrohet përsosmërisë. Ndërsa proceset përmirësohen, ato bëhen më të qëndrueshme, kompania do të jetë në gjendje të arrijë qëllimet më rregullisht, duke siguruar rezultate të prekshme. Gjithashtu, do të zvogëlohen mbetjet e pa nevojshme në çdo etapë të procesit.

6

Lehtësimi i bashkëpunimit në biznes

Fakti që certifikimet e mirënjohura janë pranuar gjerësisht e ndërkombëtarisht lehtëson realizimin e bashkëpunimit në biznes, si dhe kërkimin dhe zhvillimin e produkteve të reja. Standardizimi lejon që kompania të bëjë biznes ndërkombëtar duke siguruar përputhshmërinë dhe pandryshueshmërinë e një produkti ose një inputi të përdorur në procesin e tij.

Përfitimet e certifikimeve

Përfitimet e sipërmarrjeve të certifikuara ndahen në dy kategori: përfitime të karakterit të brendshëm dhe përfitime të karakterit të jashtëm.

Përfitimet të karakterit të brendshëm janë:

- a) përmirësimi i ndërgjegjësimit për rëndësinë e cilësisë;
- b) rritja e ndërgjegjësimit për cilësinë e kompanisë;
- c) përmirësimi i menaxhimit të kompanisë;
- d) përmirësimi i marrëdhënieve me klientët;
- e) përmirësimi i marrëdhënieve brenda organizatës;
- f) përmirësimi dhe standardizimi i procedurave të punës;
- g) përmirësimi në përcaktimin e përgjegjësive dhe detyrimeve të punonjësve;
- h) përfshirje më të mirë në punë;
- i) përmirësimi i efikasitetit;
- j) ulja e problemeve me procedurat dhe rritjen e motivimit të punonjësve;
- k) përmirësimi i ndërgjegjësimit për problemet e ndërmarrjes;
- l) përmirësimi në cilësinë e produktit.

Përfitimet të karakterit të jashtëm janë:

- a) përmirësimi i cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të ofruara;
- b) rritja e besimit në cilësinë ndaj ndërmarrjes;
- c) përgjigje e rritur e kërkesave të klientit;
- d) hyrje në tregje të reja;
- e) përmirësimi i marrëdhënieve me klientët;
- f) përmirësimi i shërbimeve ndaj klientëve;



- g) rritje e kënaqësisë së klientëve;
- h) ulje e auditimeve të klientëve;
- i) rritje e reputacionit ndaj konkurrentëve.

Gjithashtu, përfitimet e certifikimit mund të cilësohen si një mjet i rëndësishëm i marketingut që ndihmon marrëdhëniet e tregut, rrit përqindjen e tregut të zotëruar, rrit mundësinë e marrjes së kontratave të reja, zvogëlon numrin e auditimeve të klientëve dhe ndihmon në hyrjen në tregjet ndërkombëtare.

Studime të ndryshme të kryera ndër vite në rajone të ndryshme, japin rezultate të cilat shprehin se përfitueshmëria mesatare ekonomike, midis një kompanie të certifikuar dhe një kompanie jo të certifikuar, është rreth 10% më shumë përfitim financiar.

Llojet e certifikimeve

Certifikimet janë të ndryshme për sektorë e ndryshëm të industrisë.

Ndër certifikimet më të aplikuara ndërkombëtarisht mund të përmenden:

Certifikimet ISO: Këto lloje certifikimesh aplikohen mbi sistemet e menaxhimit të ngritura dhe që zbatohen nga organizata të madhësive të ndryshme, duke vërtetuar tek konsumatorët zbatimin e standardeve përkatëse.

Certifikimet CE: Certifikimet CE i adresohen produkteve jo ushqimore të cilat duan të tregtohen në Zonën Ekonomike Evropiane (EEA). Shumë produkte kërkojnë certifikim CE para se të tregtohen në Bashkimin Europian. Certifikimi, tregon që një produkt është kualifikuar nga prodhuesi dhe konsiderohet se plotëson kërkesat e BE-së për sigurinë, shëndetin dhe mbrojtjen e mjedisit. Disa produkte i nënshtrohen disa kërkesave të BE-së në të njëjtën kohë. Ndaj produktet duhet të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat përkatëse përpara se të certifikohen me CE. Vendosja e markës CE mbi një produkt të eksportuar në Evropë përbën detyrim ligjor për çdo prodhues.

Certifikimet Ushqimore: Me zhvillimin e tregtisë së lirë ndërkombëtare dhe me përparimet teknologjike globale, janë sofistikuar edhe metodat e përpunimit, prodhimit dhe shpërndarjes së ushqimit, për këtë arsye duhet kuptuar që standardet ndërkombëtare janë të nevojshme për të garantuar sigurinë e zinxhirit global të furnizimit edhe në sektorin e ushqimit. Certifikimet, për sa i përket produkteve ushqimore janë disa që varen nga tipologjia e ushqimeve, kur ndër to mund të përmendim: ISO 22000, FSSC 22000, IFS, BRC, GlobalG.A.P, Bio, MSC, etj.

Ndër certifikimet kryesore në treg mund të përmenden:

HACCP (Hazard Analysis of Critical Control Points); Është një metodologji e njohur ndërkombëtare, një mjet i cili për më shumë se 50 vjet, përdoret në një mënyrë sistematike për të parandaluar ose për të reduktuar aq sa është e mundur, rrezikun në prodhimin ushqimor. Kërkesat e HACCP mund të zbatohen në çdo pjesë të zinxhirit ushqimor, nga prodhimi dhe përpunimi primar, deri në pikën e konsumit. Përdorimi i Standardit HACCP është bërë një detyrim për të gjithë operatorët në industrinë ushqimore që nga viti 2008.

International Featured Standard; Aplikohet kur produktet janë procesuar ose kur ka një rrezik për ndotje gjatë paketimit në ambalazhet primare. Standardi IFS Food është i rëndësishëm për të gjithë prodhuesit, në veçanti për prodhuesit nënkontraktorë, të cilët kanë për qëllim të përmbushin specifikat. Theksi i jepet sigurisë ushqimore, si dhe cilësisë së proceseve dhe produkteve.

BRC (Standardi Global për Sigurinë Ushqimore i Konsorciumit Britanik të Shitjes me Pakicë); Në tregtinë botërore të ushqimit, standardi ushqimor BRC është një mjet i besueshëm për prodhuesit për t'u provuar klientëve të tyre se ata lehtësisht mund të marrin pjesë në programet e tyre të sigurisë ushqimore dhe zinxhirin e furnizimit. Standardi ushqimor BRC është zhvilluar nga shitësit me pakicë, ekspertët e industrisë ushqimore dhe organizatat e lidhura me to, fillimisht vetëm në Angli, e tashmë është një standard ndërkombëtar i përdorur nga shumica e vendeve të zhvilluara perëndimore.

Skema FSSC; Është një ndër gjashtë skemat e certifikimit, e njohur nga shoqatat e tregtisë ndërkombëtare dhe furnizuesit e lëndës së parë. Kjo skemë certifikimi ka për objekt certifikimin e gjithë kompanive të përfshira në përpunimin ose prodhimin e:

- Produkteve shtazore (përjashto thertoret);
- Produkteve afatshkurtër (që firojnë me kalimin e kohës);
- Produkteve bimore me një afat të gjatë (vitamina, drithëra dhe aditivët e tjerë ushqimore).

Global GAP; Është standard i njohur ndërkombëtarisht për prodhimin në fermë. Qëllimi kryesor i këtij standardi është prodhimi bujqësor i sigurt dhe i qëndrueshëm për të përfituar fermerët, shitësit me pakicë dhe konsumatorët në të gjithë botën.

Certifikimi GLOBAL G.A.P. mbulon:

- Sigurinë e ushqimit dhe gjurmueshmërinë;
- Mjedisin (përfshirë biodiversitetin);
- Shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e punëtorëve;
- Mirëqenien e kafshëve;
- Menaxhimin e Integruar të Kulturave (ICM);
- Kontrollin e Integruar të Dëmtuesve (IPC);
- Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (QMS);
- Analizën e Rrezikut dhe Pikat Kritike të Kontrollit (HACCP);

Standardi, ndër të tjera kërkon efikasitet më të madh në prodhim. Ai përmirëson performancën e biznesit dhe redukton humbjen e burimeve jetike. Ai gjithashtu kërkon një qasje të përgjithshme ndaj bujqësisë që ndërton praktikatat më të mira për brezat që do të vijin.

ISO 9001, Certifikimi i sistemit për menaxhimin e cilësisë; ISO 9001 përfaqëson sot pikën e referimit, e njohur në nivel botëror për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së bizneseve të të gjithë sektorëve dhe të të gjitha përmasave. Standardet e familjes ISO 9000 janë udhëzime e kërkesa se si një ndërmarrje duhet të veprojë, për të siguruar dhënien e një shërbimi cilësor, domethënë, që i përgjigjet asaj që kërkohet nga klienti. Certifikimi sipas ISO 9001:2015 është një certifikim sistemi dhe jo produkti, domethënë, nuk certifikohet malli ose shërbimi, por sistemi i menaxhimit të organizatës.

ISO 22000, Certifikimi i sistemit për menaxhimin e sigurisë së ushqimit; Në mënyrë që të ofrohet siguria e ushqimit përgjatë zinxhirit ushqimor, është i domosdoshëm Standardi ISO 22000:2018 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së ushqimit, për sigurimin e kushteve higjienike për prodhimin e ushqimit të shëndetshëm (higjiena e personelit, higjiena e pajisjeve, higjiena e lëndës së parë, e mjedisit, higjiena e përgjithshme, etj.), në kompanitë ushqimore duke përcaktuar masat për ofrimin e këtyre kushteve, prodhimin dhe shërbimin në aspektin e rrezikut shëndetësor, ku konsumatorët mund të japin arsyet që mund të përcaktojnë dhe eliminojnë këto shkaqe dhe bazohet në sistem.

ISO 14001, Certifikimi i sistemit për menaxhim mjedisor; Standarti ISO 14001 specifikon kërkesat e përgjithshme për ngritjen e një sistemi menaxhimi mjedisor në një kompani. Ai fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të kompanisë, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të kompanisë në aspektin mjedisor. Një organizatë mund të marrë dhe zbatojë certifikimin me Standartin ISO 14001:2015, pavarësisht madhësisë apo fushës së saj të veprimit.

ISO 45001, Certifikimi i sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë; Standarti ISO 45001 specifikon kërkesat për një Sistem të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (OH&S) dhe jep udhëzime për përdorimin e tij, për t'u mundësuar organizatave të ofrojnë vende pune të sigurt dhe të shëndetshme, duke parandaluar dëmtimet në punë dhe sëmundjet profesionale, si dhe duke përmirësuar në mënyrë proaktive performancën e tyre për shëndetin dhe sigurinë në punë. ISO 45001:2018 zëvendësoi OHSAS 18001, duke e ngritur në rangun e standardeve ISO.

ISO 27001, Certifikimi i sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit: 27001 është konceptuar me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit. Standardi është i zbatueshëm ndaj gjithë llojeve të kompanive, përfshirë institucionet qeveritare, kompanitë tregtare dhe agjencitë jo fitimprurëse. Përcakton kërkesat për operimin, monitorimin, përcaktimin, zbatimin, shqyrtimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacioneve të dokumentuara.

ISO 28001, Certifikimi i sistemit për menaxhimin e sigurisë në zinxhirin e furnizimit: Kjo certifikatë është e njohur edhe si sistemi i menaxhimit të sigurimit në zinxhirin e furnizimit dhe në shumë sektorë të sigurisë publike. Sistemi për menaxhimin e sigurisë në zinxhirin e furnizimit është standard ndërkombëtar ISO 28001, i cili përcakton kërkesat në zinxhirin e furnizimit dhe ky sistem ofron një model administrativ për organizatat të cilat dëshirojnë t'i zbatojnë.

ISO 50001, Certifikimi i sistemit të menaxhimit të energjisë: Versioni aktual i këtij standardi është publikuar në vitin 2018. Sistemi i menaxhimit të energjisë ndihmon shoqëritë të përdorin energjinë në mënyrë sa më efikase, duke kursyer të ardhura, si dhe mbrojtjen e mjedisit. Mund të implementohet dhe certifikohet në çdo kompani, pavarësisht madhësisë së saj, aktivitetit dhe burimet e përdorura të energjisë. ISO 50001 përfshin kërkesat për kryerjen e analizës energjitike, vendosjen dhe monitorimin e treguesve të performancës së energjisë, përcaktimin e objektivave të menaxhimit të energjisë, ndërgjegjësimin e stafit, monitorimin dhe përmirësimin e performancës së energjisë. Certifikimi ISO 50001 tregon angazhimin e shoqërisë për të përmirësuar performancën e saj dhe duke kontribuar në përpjekjet globale për të kufizuar konsumin e burimeve jo të rinovueshme.

ISO 37001, Certifikimi i sistemit të menaxhimit anti rryshfet: Ai mund të implementohet dhe certifikohet tek institucionet shtetërore, shoqëri private apo organizata jofitimprurëse. Në shumicën e shteteve në botë ekziston një legjislacion, i cili ndalon dhënien dhe marrjen e të mirave materiale të panevojshme. Ky certifikim synon të demostrojë angazhimin e shoqërisë për transparencë dhe një sjellje më etike në biznes. ISO 37001 përfshin përveç të tjerave në kërkesat e saj aspekte të tilla si zhvillimi i një politike anti rryshfet, ndërgjegjësimi i personelit, vlerësimi i risqeve, vendosja e kontrolleve financiare dhe jo financiare, me qëllim që të parandalojë aktet e korrupsionit apo ekzistencën e kanaleve të komunikimit nëpërmjet të cilave çdokush mund të transmetojë ankesa anonime në lidhje me dyshimet për korrupsion.

ISO 39001, Certifikimi i sistemit të menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor: Ai bashkon praktikat më të mira dhe njohurinë në lidhje me sigurinë e qarkullimit rrugor dhe sistemet e menaxhimit të cilësisë, në një mjet të vetëm për garantimin e menaxhimit të sigurisë.

SA 8000, Certifikimi për përgjegjshmërinë sociale: SA 8000 është standardi i parë i auditueshëm për certifikimin social në fushën e përgjegjshmërisë sociale, i krijuar në 1989 nga Përgjegjshmëria Sociale Ndërkombëtare (SAI). Ky sistem përputhet me strukturën ISO 9001, ISO 14001, dhe ISO 45001 dhe bazohet në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, konventën e ILO, Kombet e Bashkuara dhe legjislacionin kombëtar, si dhe krijon hapësira në industri dhe kode për kompanitë për matjen e performancës sociale.

ISO 22301, Certifikimi i sistemit të menaxhimit për vazhdimësinë e biznesit: Ky koncept, menaxhimi i vazhdimësisë është i gatshëm të ndihmojë shoqëritë, pavarësisht dimensionit të saj apo fushës së aktivitetit, të përballojë situatat kritike. Qëllimi është që të ketë rregullime, përgatitje dhe burime të nevojshme për të bërë të mundur vazhdimësinë e aktivitetit dhe në rastet e një incidenti madhor.

Certifikimi i produktit organik (BIO): Rregullorja organike siguron bazën për zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit organik, duke siguruar një funksionim efektiv të tregut të brendshëm, garantuar konkurrencë të drejtë, siguruar besimin e konsumatorit dhe duke mbrojtur interesat e konsumatorit.

Prodhimi organik:

- Themelon një sistem menaxhimi të qëndrueshëm për bujqësinë i cili:
 - Respekton sistemet dhe ciklet e natyrës, mban dhe përmirëson shëndetin e tokës, ujit, bimëve dhe kafshëve, si edhe ekuilibrin ndërmjet tyre;
 - Kontribuon në një nivel të lartë të larmisë biologjike;
 - Përdor me përgjegjësi energjinë dhe rezervat natyrore, të tilla si: ujin, tokën, lëndët organike dhe ajrin;
 - Respekton standarde të larta të mirëqënies së kafshëve dhe në veçanti plotëson nevojat për sjelljen specifike sipas llojeve të kafshëve.
- Synon prodhimin e produkteve me cilësi të lartë.
- Synon prodhimin e një larmie të gjerë ushqimesh dhe produkteve të tjera bujqësore që i përgjigjen kërkesës së konsumatorëve për të mirat e prodhuara nga përdorimi i proceseve, të cilat nuk dëmtojnë mjedisin, shëndetin e njerëzve, shëndetin e bimëve ose shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve.

Prodhimi organik do të mbështetet mbi parimet që vijojnë:

- Planifikim dhe menaxhim i përshtatshëm i proceseve biologjike bazuar në sistemet ekologjike duke përdorur burimet natyrore, të cilat janë të brendshme për sistemin, përmes metodave që:
 - Përdorin organizma të gjallë dhe metoda mekanike të prodhimit;
 - Ushtrjnë kultivimin e prodhimeve që lidhen me tokën dhe prodhimin shtazor, ose ushtrojnë akuakulturë që është në pajtim me parimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të peshkimit;
 - Përfshijnë përdorimin e OMGJ-ve dhe produkteve të prodhuara prej ose me OMGJ, me përjashtim të produkteve mjekësore veterinarë;
 - Janë të bazuara në vlerësimin e rrezikut dhe përdorimin e masave paraprake dhe parandaluese, kur është e përshtatshme. Bujqësia organike kufizon përdorimin e lëndëve shtesë dhe ndihmuesit e përpunimit, si dhe inpute të tjera të jashtme.
- Çdo herë që blini një produkt të certifikuar organik nga supermarketi juaj apo zgjidhni një në restorantin tuaj të preferuar, mund të jeni të sigurt se ato janë prodhuar sipas rregullave strikte që respektojnë mjedisin dhe mirëqenien e kafshëve.

Certifikim Hallall

Certifikimi Hallall zbatohet për sektorët e ushqimit, kozmetikës dhe farmaceutikës dhe vërteton se një produkt është prodhuar në përputhje të plotë me parimet e fesë islame, se nuk përfshin asnjë komponent "të ndaluar" dhe nuk ka qenë në asnjë mënyrë në kontakt me asnjë substancave ose objekteve të konsideruara "të papastra".

Ky certifikim shërben për:

- Garantimin e konsumatorëve musliman që parimet e tyre fetare janë respektuar;
- Sigurimin e një niveli të lartë të higjienës dhe sigurisë së produktit;
- Përgjigje ndaj kërkesës në rritje për prodhimet Hallall në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare.



Trupat certifikuese

Trupat certifikuese për Standartet ISO të akredituara në Shqipëri nga Drejtoria e Përgjigjthshme e Akreditimit:

- 1.European Quality and Safety Control (EQSC): www.eqsc-cert.org
- 2.ICDQ Albania: <https://icdq.al>
- 3.Legal Cert: <https://www.legalcert.al/al>
- 4.AQSCERT: <https://aqscert.org>
- 5.CAREER CERT INSTITUTE SHPK (CCI): <https://ccertinstitute.com>
- 6.Certis: <https://certis.com.al/>
- 7.AXE REGISTER: <https://www.axe-register.com>
- 8.UNICERT sh.p.k: canka.vjola@gmail.com
- 9.WR ERN BERATUNG sh.p.k CERT-ERN: <https://certern.org/>

Trupat certifikuese kryesore për GLOBAL GAP, BIO, HALLALL që operojnë në Shqipëri:

- 1.European Quality and Safety Control (EQSC): www.eqsc-cert.org
- 2.Bio-inspecta: <http://bio-inspecta.al>
- 3.SRS: www.srs-certification.com


Kompanitë kryesore të konsulencës për Standartet ISO, GLOBAL GAP, BIO dhe HALLALL që operojnë në Shqipëri:

- 1.TMC Training Management Consulting: www.tmc-al.com
- 2.QPLAN Internationla Netëork of Experts: www.qplan-ine.com
- 3.TBI Consulting: <https://www.tbi-al.com/>
- 4.AZ Consulting: <https://azconsulting.al/>
- 5.CBS: <https://www.cbs.al/al/>





invest in Albania



AIDA - Albanian Investment
Development Agency




aida_albania



AIDA - Albanian Investment
Development Agency




investinalbania



aida.gov.al



info@aida.gov.al



+355 [0]42 251 001